



e Rahovecit

Ballkoni panoramik - investim për transformim të turizmit në Rahovec

Nisën punimet për ndërtimin e ballkonit panoramik mbi qytetin e Rahovecit.

Kryetari Latifi, bashkë me ministrin e Zhvillimit Rajonal, z. Fikrim Damka, me bashkëpunëtorë e me qytetarë, mori pjesë në fillimin e punimeve të projektit “Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit”, bashkëfinancim i Komunës së Rahovecit dhe i MZHR-së.

Këtë projekt e kanë quajtur "Grape city", i cili është një hap i rëndësishëm në drejtimin e zhvillimit të turizmit të qytetit të Rahovecit.

Ky ballkon do të shërbejë si një vend unik për vizitorët dhe për qytetarët, duke ofruar pamje të peizazhit të mrekullueshëm që na rrethon.



Në Krushë të Madhe, nisi festivali AgroFesta

Ky festival i dedikohet perimekulturës dhe është një prej mënyrave më të mira për ta promovuar kultivimin e perimtarisë, duke e konceptualizuar edhe dimensionin kulturor që e ka veprimtaria bujqësore në komunën tonë. Festivali u zhvillua në kuadër të muajit të mërgimtarëve



Çmimi: Dekorata për Humanizëm “Dr. Ali Sokoli” i jepet Prof. Dr. Sadri Bajraktari

Komuna e Rahovecit nderoi Prof. Dr. Sadri Bajraktarin me Dekoratën për Humanizëm “Dr. Ali Sokoli”, i cili është një mjek e humanist i shquar që gjithë jetën ia kushtoi përmirësimit të mirëqenies së popullit shqiptar.



Hapen dyert për bizneset në Rahovec - 8 lokale të reja afariste zejtare

Komuna e Rahovecit përruroi lokalet afariste zejtare në Rahovec, një hap kyç në zhvillimin ekonomik, që pritet të sjellë gjallëri në tregun lokal dhe të nxisë hapjen e vendeve të reja të punës.

Objekti përmban:

- 8 lokale në dy kate, në sipërfaqe prej 420 m².
- Parkingje të shënuara sipas standardeve, në sipërfaqe prej 930 m².

